




**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**

Referenca: 626-19-026-5-2-1

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Udhëheqësít të Sektorit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njérén anë:

Dhe

Grupi i Operatorëve Ekonomik: "Xhevdet Buzhala" B.I. me emrin tregtar N.N.P. "AUREX" me nr. të biznesit: 811040386 me seli në Suharekë dhe "Lani-AL" SH.P.K. me numër të biznesit: 810856651, selia në Suharekë të cilët në bazë të autorizimit i përfaqëson z. Arlind Buzhala, ne cilesinë e Menaxherit të N.N.P. "AUREX" (ne vazhdim "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për punë si me poshtë:

Titulli i Kontratës: NDËRTIMI I KANALIZIMIT ATMOSFERIK DHE NDËRTIMI I RRUGËVE FUSHORE NË MAMUSHË -RITENDER

me numër identifikues: 626-19-6666-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1. Lënda e kësaj kontrate ka të bëjë me ndërtimin e kanalizimit atmosferik përgjatë rrugëve fushore si dhe ndërtimi i rrugëve fushore në Mamushë në të cilat do të kryhen punët si më poshtë:

Ndërtimi i Kanalizimit Atmosferik dhe Ndërtimi i rrugëve fushore në Komunën e Mamushës - Faza e Parë

| PARAMSA DHE PARALLOGARIA PËR RRUGËT FUSHORE NË KOMUNËN E MAMUSHËS | |
|--|--|
| GJATËSIA E RRUGËVE L= 2500 m'. | |

| Nr. | Përshkrimi i artikullit | Njësia | Sasia |
|----------|--|---------|----------|
| 1 | Punët Parapregaditore | | |
| 1 | Mobilizimi i kompanise dhe rregullimi i punishtes për punë. | Komplet | 1.00 |
| 2 | Shënim, piketimi i rrugëve, matjet gjeodezike të trasës së rrugëve fushore si dhe përcjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit . Vërejtje : Rrugët janë planifikuar të hapen (rrugë të reja), zgjerohen (rrugët ekzistuese) me gjerësi deri 6 m sipas gjendjes në teren dhe kërkesës nga Menaxheri i Projektit . | m' | 2,500.00 |
| 3 | Identifikimi instalimeve nëntoksore dhe mbitokesore, riparimi i tyre në raste dëmtimi. | m' | 2,500.00 |

| | | | | |
|----------|--|--------------|--|-----------|
| 2 | PUNËT DEMOLUSE | | | |
| 1 | Pastrimi i terenit nga mbeturinat,e ngurta,shkurret drunjë dhe rrrehojave në zonat ku do të kalojë traseja e rrugës. Pastrimi i tyre bëhet normal me drejtimin e rrugës me gjërësi deri 6 m^3 . Deponimin e materialit të demoluar e cakton Investitori. Në këtë pozicion përfshihet edhe demolimi i rethojave dhe kthimin në gjendje të mëparshme pas përfundimit të punimeve. | m^3 | | 2,500.00 |
| 2 | Pastrimi dhe funksionalizimi i lëshesave (Tombinave) egzistuese të cilat janë jashtë funksioni për shkak të mbylljes së tyre. Ne cmim te llogaritet rregullimi me beton i kokave hyrese dhe dalese te leshesave. | m^3 | | 250.00 |
| 3 | PUNËT TOKESORE | | | |
| 1 | Zgjerimi i rrugeve ne te dy anet ku perfshihet germimi i dheut anash rruges ekzistuese ne lartesi deri 1 m pasi qe rruga eshte ne disniveli si dhe transporti në deponi , ku e cakton Menaxheri i projektit. (rruget ekzistuese jane ne gjeresi max. 3 m) | m^3 | | 3,750.00 |
| 2 | Sherbime me eskavator per pune te ndryshme | orë | | 90.00 |
| 3 | Gërmimi i dheut kategorisë III-VI ,deri në thellësinë $t=60\text{ cm}$ si dhe transporti i materialit deri në deponi ku e cakton Investitori. | m^3 | | 9,300.00 |
| 4 | Gërmimi i dheut të kategorisë së III-VI-të,për formimin e kanaleve anësore në form trapezi për largimin e ujërave atmosferik, me ngarkim dhe bartje deri në deponi , ku e cakton Menaxheri i projektit. Ky pozicion duhet te punohet sipas matjeve gjeodezike per largimin e ujërave nga rruget deri tek lumi, pasi qe ka disnivele te medha. | m^3 | | 4,000.00 |
| 5 | Formësimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës me ngjeshmeri $Mv \geq 25\text{ MN/m}^2$. | m^2 | | 18,750.00 |
| 4 | PUNËT SIPERFAQËSORE (Mbushja) E RRUGËVE | | | |
| 1 | Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës së bazës së rrugëve nga guri natyral $0-150\text{mm}$, me trashësi të shtresës $t=30\text{ cm}$ si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes $Mv \geq 50\text{ MN/m}^2$. Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezantoj tek menaxheri i projektit dhe organi mbikëqyrës. | m^3 | | 5,250.00 |
| 2 | Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës së rrugëve me zhavorr nga gurit të thyer fraksion $0-63\text{ mm}$, me trashësi të shtresës $t=25\text{ cm}$ si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes $Mv \geq 70\text{ MN/m}^2$. Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezantoj tek menaxheri i projektit dhe organi mbikëqyrës | m^3 | | 4,062.50 |

| | | | |
|---|--|----------------|----------|
| 3 | Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës së rrugëve me zhavorr nga gurit të thyer fraksion 0-31.5mm, me trashësi të shtresës $t=15$ cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes $Mv \geq 100$ MN/m ² . Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezantoj tek menaxheri i projektit dhe organi mbikëqyrës | m ³ | 2,437.50 |
| 5 | PUNËT E LËSHESAVE | | |
| 1 | Furnizimi , transporti dhe vodosja e lëshesave (tombinave) rrethore prej gypave Ø400mrn të parapregaditura nga betoni ,Kokat hyrëse dhe dalëse të lëshesave të pregaditen dhe punohen nga kallepët prej drrasave BA betoni C25/30 . Ky pozicon do te realizohet ne secilen parcele per hyrje dhe dalje. | m' | 550.00 |
| 2 | Furnizimi , transporti dhe vodosja e lëshesave (tombinave) rrethore prej gypave Ø600mrn të parapregaditura nga betoni .Kokat hyrëse dhe dalëse të lëshesave të pregaditen dhe punohen nga kallepët prej drrasave BA betoni C25/30 . | m' | 55.00 |

Vërejtje:

Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standarde Europiane dhe Eurokodit , Kompania punë kryese është përgjegjëse për ti marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjetet sinjalizuese para fillimit të punët, në gjithë zonën ku do të zhilloj aktivitet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntoksore, të qytetarve është e obliguar ti kthejë në gjendje të mëparshme me kostot të vetën financiare.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **43,306.50 €;**

Katërdhjetetremijë e treqind e gjashtë Euro e Pesëdhjetë Eurocent.

2.2 Çmimi i përmendor në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen rië pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) Prosesverbal i mbledhjes informative në mes të Punëkriesit, organit mbikëqyrës dhe menaxherit të kontratës i cili do të mbahet para nënshkrimit të planit të menaxhimit të kontratës me datë 18.10.2019 ora 10:00.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartesisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet



4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa heqë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvèç nëse specifikohet ndryshtësia e njoftimit të tillë, pëlqimi, miratimi, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vértojë", "miratoj" "ose" vendosë "do të interpretohen në përpjekje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinalë, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinalë për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

| | | | |
|--------------------|---|--------------------|--|
| Emri: | Gazmend Gashi | Emri: | Arlind Buzhala |
| Pozita: | Udhëheqës i sektorit të Prokurimit | Pozita: | Menaxher |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |  |
| Data: | 17.10.2019 | Data: | 17.10.2019 |
| Vula: | | Vula: | |

1. PJESA II E KONTRATES PËRGJITHSHME

KUSHTET

E

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "**Kontratë**" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dbe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "**Punë**" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dbe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtuesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "**Kontraktuesi**" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 “**Menaxheri i Projektit**” është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t’i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 “**Çmimi Kontratës**” do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 “**Vendi i ndërtimit**” do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 “**Pajisjet e kontraktuesit**” do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 “**Skicat**” nënkuqtojnë vizatimet, logaritjet, informata e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontaktuara.

1.9 “**KPK**” do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “**KVK**” do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përekon tonë gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përshtim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitiveve të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër finaneiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te osftës. Ne rast te ndryshimt te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontratës, Kontraktuesi duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojishme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjesë të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligime e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e lejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkthazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi. Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t’i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përshtimjet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Obligimet e Autoritetit Kontraktues

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshua Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përpjathje me ecurinë e punimeve, do ti jep qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjate shfrytëzimit, duhet të mirembaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do t' ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihami lidhur me rregulloref vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërët apo ligjet anësore të Republikës se Kosovës të eilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitive të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do t' bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për fiam ljet e tyre.

Obligimet e Kontraktuesit

Neni 86 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet t' e veprojë sipas urdhreve admisistrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhrit administrativ shkon përtjerë fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do t' pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe t' e veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do t' sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dñe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe t' e veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do t' publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do t' ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do t' siguroj se punët do t' fillojnë ehe të përfundojnë brenda asfatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do t' siguroj që të gjitha punët që aizajo do t' bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do t' bëhen në kohë dhe në përpjathje me standarde, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe përmë tepër me shkallën e afërsisë dhe zellit, e cila do t' pritet nga një kontraktues i astë dhe me përvojë që ka ncërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do tē siguroj pēr cilēsinē e punēs dhe pēr cilēsinē e materialeve dhe cilēsisē profesionale tē punonjēsve qē janē pērdorur pēr realizimin e punēve tē kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet tē siguroj zonēn e ndērtimit menjēherē pas fillimit tē punēs pēr arsyet e mēposhtme:

a. nē qoſtē se pēr kryerjen e punēve pajisjet e rēnda si: ekskavatorē tē llojeve tē ndryshme, vinča, kamionē tē llojeve tē ndryshme, skela tē larta, etj do tē pērdoren dhe

b. nē mēnyrē qē tē mos dēmtojē kalintarēt e rastit objektet pērreth, traſikun etj.

8.9 Kontraktuesi do tē jetē pērgjegjēs pēr sigurinē e tē gjitha aktviteteve nē vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet tē punēsoj personel kyç dhe tē pērdor pajisje tē identifikuara nē tender e tij, pēr tē kryer punē ose personel tjetēr dhe pajisje tē aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do tē aprovoj qđo zēvendēsim tē propozuar tē personelit kyç dhe pajisjeve vētēm nēse kualifikimet e tyre pērkatēse, ose karakteristikat janē nē thelb tē barabarta ose mē tē mirē se ato tē propozuara gjatē tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do tē, jo mē vonē se dita e nēnshkrīmi tē kontratēs, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri pēr ekzekutim tē plotē dhe tē mire tē kontratēs. Shuma e sigurisē do tē saktēsohet nē KVK. Siguria e ekzekutimit do tē ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues pēr çfarēdo humbjeje qē əshtē pasojē e mosekzekutimit tē plotē dhe tē duhur tē obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do tē vazhdoj tē mbetet i vlefshēm 30 dītē pas lēshimit tē **Certifikatēs sē Pranimit te Pērkohshēm**.

10.3 Siguria e ekzekutimit tē kontratēs do tē jetē nē formēn e dhēnē nē pjesēn IV tē kontratēs.

Neni 11 Pērgjegjēsia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa tē lēshohet Certifikata e Korrigjimit tē Defektive, irreziqet e lēndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dēmtimi i pronēs (pērfshirē, pa kužizim, Punēt, Implantet, Materiale, dhe Pajisjet) janē irreziqet e Kontraktuesit dhe pronēs sē afērt.

11.2 Kontraktuesi duhet tē siguroj njē sigurim nga dita fillimit tē punimeve deri nē fund tē periudhēs garantuese tē defektive nē shumat e pēreaktuara nē KVK pēr ngjarjet e mēposhtme tē cilat janē pēr shkak tē irreziqeve tē Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dēmtim i Punēve, Implanteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dēmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dēmtim i pronēs (pērvēç Punēve, Implanteve, Materialeve dhe Pajisjeve) nē lidhje me Kontratēn; dhe
- (d) dēmtim ose vdekje e personelit te tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 dītēve pas nēnshkrīmit tē kontratēs duhet tē dērgojē Autoritetit Kontraktues policeñ dhe certifikatēn pēr sigurim qē ka pēr qəllim kompensimin e nevojshēm pēr tē siguruar humbjen apo dēmet e pēsuara.

11.4 Nē qoſtē se kontraktuesi nuk ofron njē sigurin tē tillē atēherē kontrata do tē konsiderohet e anular dhe kontraktuesi do tē pērjashtohet nga pjesēmarrja nē aktivitetet e prokurimit pēr jo mē pak se njē vit.

11.5 Nē qoſtē se ekzistojnē arsyē tē mjaftuesnime dħe bindēse pēr zgħażjen e afatit tē ofrimit tē certifikatēs mbi sigurim. Autoriteti Kontraktues mund tē zgħas āfġat e caktuar pēr dorżiġmin e certifikatēs mbi sigurimin ose te eliminojē sigurimin dħe tē zbres ċemmin e shpērblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohēs se specifikuar ne KVK, kontraktuesi do tē dorżoġej Menaxherit tē Projektit njē program pēr miratim. Programi do tē pērmbaje se paku me se vijon: mēnyrēn se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punēve, afatit kohor qe kērkohet pēr dorżiġ dhe miratim te vizati meve, metodat e pērgjithshme qe do tē zbatoje, dhe afatit kohor pēr seċi lin aktivitet tē specifikuar.

12.2 Nēse menaxheri i projektit pēr me teper kērkon modifikkime ne programin e punēve nē kuadēr tē punēve tē kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojē edhe njēherē programin dhe tia kthejē prapē Menaxherit tē projektit. Kontraktuesi do tē azhurnoj Programin nē intervallu jo mē shumē se periudha e pēreaktuar nē KVK.

12.3 Pēr qđo pakēnaqṣi apo mosmarrēveshje nē lidhje me modifikkimin e programit, kontraktuesi do tē siguroj argument me shkrim Menaxherit tē Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëloj ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend-punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndaloj qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuara nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agentëve te Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksidet i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahan. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë te cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsyë mund të kërkojen nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tillë si rrugë, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroportë. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet ne peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë te veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përfshiruar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet ne shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ate sryken nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues përfshirë masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit te shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritur të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para corëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar përfshirë shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që de të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigimit të Dëfekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosverprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, përfshirë nga këto arsyet:

a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;

b) Foresa madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues

se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit te detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zgres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë konratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

Materialet dhe mjeshtëritë

Neni 20 Registri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përvç kur parashikot e ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mësojë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës qe detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrëthanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;
- b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuar dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogarijen e pagesave qe duhet bere Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune ne progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon ce të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pëtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marr një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetit Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të janë në përpunë me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë përdorimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të janë objekti i një kërkese të dërguar nga Kontraktues tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet ti referohet numrit te kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do te zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkese duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jejet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur rë KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filloj që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet te dorëzohen në kohë në vend për ti lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do ti lejohet që të paraqesë ndonjë arsyë përvonesë në përm bushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshterinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshteria kanë cilësimë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjeter, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar teste, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do te miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pëtuhet për rezultatet e testit, secili do të jepë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjeterit brenda 15 ditëve pas ngrijës se mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund t'ë kërkojnë që këto teste të përsërten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimt do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve përvonesë të Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të janë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilët dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia férhequr vërejtjen se ato mund t'ë ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato ne skica apo ne specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët ne kontrate vlerësojnë se ndërrimet substanciale te punëve janë bere te nevojshme për shkak te gabimeve te tillë ose te përfjashtimeve te cilat substancës së mund t'ë ndikojnë ne çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do te korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit te Prokurimin Publik.

PAGESAT

Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhetëme dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumëm e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikatë. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do t'ë llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do t'i konsiderohen të mbuluar nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet te bëhen sipas fakturës se lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkuesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Parallogaria

25.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbyjnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet përsasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përbaj aktivitetet me çmim përvonesë kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për nenoitëm dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të

cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënic Kontraktuesit të shumave të përeaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënicë është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim e tërë të Punëve. Kjo shume ne asnjë rast nuk do te tejkaloj 10% e vlerës totale te kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendosoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur osë garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimive të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëj vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e neçyshmeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogarita përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft te deklaratës se llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në cetaje vlerën e punës së bëre në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës se llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përeakton:

- Shumen e cila sipas opinionit te tij duhet t'i paguhet sëpas kontratës; dhe
- pas evidentimit te shumave te paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bila icj, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund te jetë rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshoje te autoriteti kontraktues ose te përsaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumen përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues, ose përsaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të

nënshtkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshtkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtryrje pa dhëndë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afat e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin e tij zbulojë ose kryej testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbime komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsyё të justifikuar vonehet në lëshimin e vërtetimit përmbytje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktivitetave të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFËKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me cëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk është përgesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi te jete informuar prej tij paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa te jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm**.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përvèç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontraten dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose t'i lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose t'i refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderehet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkizazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuarra ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe /ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pësshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh nconjë dëm gjatë periudhës së përmendor, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përeaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- të kryejë vetë punc, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kostot te Kontraktuesit, në të cilin rast kostojta e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arril et menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurrit të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të parashihet në KVK dhe specififikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë se defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektit apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje. Autoriteti kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet evenuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të janë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tillë do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen cëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguher Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprenë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e purës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsyen e justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kostot vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përekuar nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës përi numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës përi raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materia e e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajt të palës së tretë krijohen rrëthana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlgjimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimesmë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhë ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin përi punët e kryera deri në momenin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 **“Force Madhore”** siç përdoret këtu mendohet në çregullimet industriale, çregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërsimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajn apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhë jashë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përfaqton Forceën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të chënët e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësítë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre;
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të zgjashme i bart kontraktuesi;
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritë nga dita e ngjarjes që përfaqton Forceën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin;
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe përi një periudhë përi aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit;
- v. Në qoftë se kontraktuesi përi një kohë të gjatë është bërë i pa afës, për shkak të Forceos Madhore, përi t'i kryer obligimet dhe përgjegjësítë e parapara me kontratë. Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin përi ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përi lindur dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjale dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të ekuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e

borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues. Menaxheri i Projektit do të ëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, rikthesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet che pajisjet e ndërtimit në vend punim, Implantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të janë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërprite; për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Liriimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësitet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kérkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kérkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjësja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kérkesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kérkojë:

- ose vendim nga gjyqi;
- kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

KUSHTET EVEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| Përshkrimi i nenit | Neni. Nr. | Kushtet dhe detyrimet |
|---|------------------|--|
| Kushtet e Veqanta të Kontratës | 1. | <i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i> Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK mund të bëhet vetëm me pëlgimin e të dyja palëve kontraktuese. |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2. | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridikson do të ketë gjykata përkatëse në Prishtinë. |
| | 2.1 | Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 3. | Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Përgjegjësia e kontraktuesit është ne rast te shkaktimit te dëmeve ne persona, staf apo objekte përreth. Çdo dëmtim të instalimeve nëntoksore të qytetarve apo dëmtime të pronave dhe objekteve tjera është e obliguar ti kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare. |
| Programi | 4. | Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 2 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës. |
| | 4.1 | Periudha për Programin e azhurnuar është 2 ditë pas datës së nënshkrimit të kësaj kontrate. |
| Kualitetit i Punimeve | 4.2 | Punët duhet të kryhen sipas specifikave teknike të paraqitura në nenin 1 të kontratës. Të gjitha punët duhet të kryhen në përputhje me normat teknike dhe standardeve Europiane dhe Eurokodit, Kompania punë kryese është përgjegjëse për ti marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjetet sinjalizuese para fillimit të punëve, në gjithë zonën ku do të zhvilloj aktivitetet e saj. Menaxheri i Projektit dhe organi mbikëqyrës: Menaxheri i projektit është caktuar nga ana e kryetarit të Komunës me vendimin nr. 02 Nr.08-18, të datës 17/01/2018 Mbikëqyrjen do ta bëjë Operatori Ekonomik "TRIANGLE"SH.P.K në bazë të kontatës për mbikëqyrjen e projekteve ndërtimore të vitit 2019. |
| Fillimi i punëve | 6. | Data e fillimit të punimeve sipas planit dinamik të kontraktuesit do të jetë me: 18.10.2019 |
| Përfundimi i punëve | 6.1 | <i>Punët do të ekzekutohen në bazë të planit dinamik të cilin e ka paraqitur kontraktuesi në tenderin e tij për një periudhë prej 27 ditëve të punës. Ditet e punës do te llogariten sipas regjistrimit në ditarin e punës nga kontraktuesi dhe të konfirmuara nga Organit Mbikëqyrës. Kontraktuesi punët duhet ti kryej pa ndërprerje në përjashtim të pengesave të pa parashikura të cilat nëse janë të justifikueshme do të arësyetohet nga menaxheri i kontratës.</i> |
| Përmirësimi I defekteve | 7. | <i>Periudha për përmirësimin e defekteve është brenda afatit prej 5 ditëve pas dorëzimit të kërkesës (Vërejtjes) nga ana e Organit Mbikëqyrës të kontratës.</i> |

| | | |
|--|-----|--|
| Fillimi i realizimit të punëve (dorëzimi i vend punishtes) | 8. | <i>Data e posedimit të vend punimit do të jetë menjëherë pas nënshkrimit të planit për menaxhimin e kontratës. Plani i menaxhimit te kontratës do te behet brenda 2 ditëve të punës pas nënshkrimit të kontratës.</i> |
| Dëmet e likuiduara | 9. | Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së punëve të pa dorëzuara/realizuar për një ditë vonese. Autoriteti Kontraktues mund t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës. <i>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës.</i> |
| Garacioni i kualitetit të punëve | 10. | <i>Garacioni i kualitetit të punëve do të jetë 12 muaj. Pas përfundimit te punimeve para pagesës së fundit kontraktuesi duhet të sjellë garancionin për kualitet te punimeve ne vlore 10% te shumës së përgjithshme të kontratës te vlefshëm për 13 muaj.</i> |
| Parapagimi | 11. | Shuma e Parapagimit është: N/A |
| Mbajtja e Parasë | 12. | Shuma e parave të mbajtura është: N/A |
| Pagesa e mjeteve | 13. | <i>Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate me të cilën vërteton pjesën e përfunduar të punëve të ekzekutuar sipas kontratës. Ministria e Zhvillimit Rajonal në bazë të marrëveshjes për bashkëfinancim do të paguaj faturat pas përgaditjes së dokumentacionit të cekura në nenin 4 të marrëveshjes së datës 17.04.2019.</i> |
| Siguria e ekzekutimit | 14. | Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës totale të kontratës, kontraktuesi do ta dorëzojë sigurinë e ekzekutimit para nënshkrimit të kësaj kontrate të vlefshëm për një periudhë prej 60 ditëve. |
| Pagesa pas shkëputjes së kontratës | 15. | Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktues n për kompletimin e Punëve, është përqindja të cilën e nxerrë Organi Mbikëqyrës në bashkëpunim me menaxherin e projektit pas kontrollimit dhe vlerësimit të punëve të moatura pa u përfunduar sipas kësaj kontrate dhe specifikimeve teknike në dosje të tenderit. |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve | 16. | Palët do të tentojnë që ti zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë miqësore. Sapo te shfaqet ndonjë mosmarrëveshje palët do ta njoftojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e mosmarrëveshjes dhe do ti sugjerojnë palës tjeter mbi variantin e zgjidhjes së kësaj mosmarrëveshje. |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 17. | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Ekonomike në pajtim me ligjin në Kosovë. |



Republika e Kosovës -- Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Mamusa - Belediyesi - Komuna e Mamushës
Opština Mamusa - Municipality Of Mamusa



PËRSHIKIMI I ÇMIIMEVE

Titulli i Tenderit: Ndërtimi i Kanallimit Atmosferik dhe Ndërtimi i rrugëve fushore në Mamushës

626-19-5260-5-2-1

Nr i brendshëm

626-19-026-5-1-2

Ndërtimi i Kanallimit Atmosferik dhe Ndërtimi i rrugëve fushore në Komunën e Mamushës - Faza e Parë

| PARAMSA DHE PARALLOGARIA PËR RRUGËT FUSHORE NË KOMUNËN E MAMUSHËS | | | | | |
|---|---|----------------|-----------|---------------------------|-----------------------|
| GJATËSIA E RRUGËVE L= 2500 m ² . | | Njësia | Sasia | Çmimi për njësi me TVSH € | ÇMIMI TOTAL ME TVSH € |
| Nr. | Përshkrimi i artikullit | | | | |
| 1 | PUNËT PARAPREGADITORE | | | | |
| 1 | Mobilizimi i kompanisë dhe rregullimi i punishtes për punë. | Komplet | 1 | 580 | 580 |
| 2 | Shënim, piketimi i rrugëve, matjet gjeodezike të trasës së rrugëve fushore si dhe përcjella e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit. Vërehje : Rrugët janë planifikuar të hapen (rrugë të reja), zgjerohen (rrugët ekzistuese) me gjëresi deri 6 m sipas gjendjes në teren dhe kërkesës nga Menaxheri i Projektit. | m ² | 2,500.00 | 0.2 | 500 |
| 3 | Identifikimi i installimeve nëntoksore dhe mbëtokesore, riparimi i tyre në raste dëmtimi. | m ² | 2,500.00 | 0.2 | 500 |
| | | | | | 1580 |
| 2 | GJITHSEJ: PUNËT PARAPREGADITORE | | | | |
| 1 | Pastrimi i terrenit nga mbeturinat, ngurta, shkurret drunjë dhe rrëthojave në zonat ku do të kalojë traseja e rrugës. Pastrimi i tyre bëhet normal me drejtimin e rrugës me gjëresi deri 6 m ² . Deponimi i materialit të demoluar e caktos Investitorë. Në këtë pozicion përfshihet edhe demolimi i rrëthojave që kthimë në gjendje të mëparshme pas përfundimit të puninive. | m ² | 2,500.00 | 0.5 | 1250 |
| 2 | Pastrimi dhe funksionalizimi i lëshesave (Tombinave) e gjithsej të cilat janë jashtë funksioni për shkak të mbylljes së tyre. Ne çmim te illogaritet rregullimi me beton i kokave hyrese dhe daleše te lëshesave. | m ² | 250 | 1.2 | 300 |
| | GJITHSEJ: PUNËT DEMOLUSE | | | | 1550 |
| 3 | PUNËT TOKËSORE | | | | |
| 1 | Zgjerimi i rrugëve ne to dy anet ku përfshihet gjermimi i dheut anash rruges ekzistuese ne lartesi deri 1m pasqje rruga eshte ne disniveli si dhe transporti ne deponi, ku e caktos Menaxheri i projektit. (rruge ekzistuese janë ne gjeresi max.3m) | m ³ | 3,750.00 | 0.5 | 1875 |
| 2 | Sherbime me eskavator per punë te ndryshme | orë | 80 | 110 | 9900 |
| 3 | Gërmimi i dheut kategorisë III-VI ,deri ne thellësinë t=60 cm si dhe transporti i materialit deri ne deponi ku e caktos Investitorë. | m ³ | 9,300.00 | 0.58 | 5394 |
| 4 | Gërmimi i dheut të kategorisë së III-VI-të,për formimin e kanaleve anësore në form trapezi për largimin e ujërave atmosferik, me ngarkim dhe bartje deri në deponi , ku e caktos Menaxheri i projektit. Ky pozicion duhet te punohet sipas matjeve gjeodezike per largimin e ujërave nga rrugët deri tek lum, pasiqe ka disnivele te medha. | m ³ | 4,000.00 | 0.55 | 2200 |
| 5 | Formësimi dhe ngleshja e nënbasës së trupit të rrugës me ngleshmeri Mv≥ 25 MN/m ² . | m ² | 18,750.00 | 0.07 | 1312.5 |
| | GJITHSEJ: PUNËT TOKËSORE | | | | 20681.5 |

| PUNËT SIPERFAQËSORE (Mbushja) E RRUGËVE | | | | | |
|---|--|--------------|----------|-----|---------|
| 1 | Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës së bazës së rrugëve nga guri natyral 0-150mm , me trashësi të shtresës ($t=30$ cm si dha ngjeshja e tij me cilindrë vibrues deri sa të fitohet moduli i njësjes $Mv \geq 50 \text{ MN/m}^2$. Sëqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin modulli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri i projektit dho organi mbikëqyrës. | m^3 | 5,250.00 | 1.5 | 7875 |
| 2 | Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës së rrugëve me zhavorr nga guri të thyer fraksion 0-63 mm, me trashësi të shtresës ($t=25$ cm si dha ngjeshja e tij me cilindrë vibrues deri sa të fitohet moduli i njësjes $Mv \geq 70 \text{ MN/m}^2$. Sëqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin modulli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri i projektit dho organi mbikëqyrës | m^3 | 4,062.50 | 1.5 | 6093.75 |
| 3 | Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës së rrugëve me zhavorr nga guri të thyer fraksion 0-31.5mm, me trashësi të shtresës ($t=15$ cm si dha ngjeshja e tij me cilindrë vibrues deri sa të fitohet moduli i njësjes $Mv \geq 100 \text{ MN/m}^2$. Sëqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin modulli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri i projektit dho organi mbikëqyrës | m^3 | 2,437.50 | 1.5 | 3656.25 |
| GJITHSEJ: PUNËT SIPERFAQËSORE (Mbushja) E RRUGËVE | | | | | 17625 |
| PUNËT E LËSHESAVE | | | | | |
| 1 | Furnizimi , transporti dhe vodosja e lëshesave (tombinave) rrethore prej gypave Ø400mm të parapregaditura nga betoni ,Kokat hyrëse dhe dalëse të lëshesave të pregaditen dhe punohen nga kallepët prej drrasave BA betoni C25/30 . Ky pozicion do te realizohet ne secilën parcele per hyrje dhe dalje. | m^3 | 550 | 3 | 1650 |
| 2 | Furnizimi , transporti dhe vodosja e lëshesave (tombinave) rrethore prej gypave Ø600mm të parapregaditura nga betoni ,Kokat hyrëse dhe dalëse të lëshesave të pregaditen dhe punohen nga kallepët prej drrasave BA betoni C25/30 . | m^3 | 55 | 4 | 220 |
| GJITHSEJ: PUNËT E LËSHESAVE | | | | | 1870 |

Vërejtje:

Të gjitha punët dohet të ekzekutohen në përpunëje me normat teknike dhe standarde Europiane dhe Eurokodit , Kompania punë kryese është përgjegjëse për ti marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjetet sinjalizuese para fillimit të punëve, në gjithë zonën ku do të zhvilloj aktvitet e saj. Qdo dëmitim të instalimeve nëntoskore, të qytetarve është e obliguar ti kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vlefë financiare.

| REKAPITULLIMI TOTAL | | |
|--|---|---------|
| 1 | PUNËT PARAPREGADITORE | 1580 |
| 2 | PUNËT DEMOLUSE | 1550 |
| 3 | PUNËT TOKËSORE | 20681.5 |
| 4 | PUNËT SIPERFAQËSORE (Mbushja) E RRUGËVE | 17625 |
| 5 | PUNËT E LËSHESAVE | 1870 |
| Totali i përgjithshëm duke aplikuar të gjitha taksat dhe tatimet | | 43306.5 |

| Identifikimi i Operatorit Ekonomik | |
|------------------------------------|-----------------|
| Emri i Kompanisë | NNP „AUREX“ |
| Adresa e Plotë | SUHAREKE |
| Përfaqësuar Nga: | |
| Emri & Mbiemri | Xhevđet BUZHALA |
| Pozita | DREJTOR |
| Nënshtaktimi | X/12/2019 |
| Data | 16/09/2019 |
| Vula | |